| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.3.1 | **Identifikohen dhe adresohen rastet e fëmijëve të ri-atdhesuar** | ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon familjet e ri-atdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve. ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të ri-atdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet. Kjo përkrahje nënkupton mbulimin e shpenzimeve financiare për këto shërbime dhe për vajtje-ardhje në MASHT/Prishtinë. Supozohet që brenda një viti mund të ketë 10 raste të tilla. | 2024-2025 | ZKKK | DKA, OJQ-të dhe donatorët |
| | | | | **Nën-Totali 1.3** | |

| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.1 | **Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimit për komunitetet** | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimit për komunitetet rom dhe ashkali.<br>Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencial, por edhe publikut në përgjithësi për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve.<br>Pjesë integrale e kësaj fushate do të jetë edhe Inspektorati i Punës, të cilët do të informonin të punësuarit për dëmet dhe pasojat e ekonomisë informale. | 2024-2026 | ZKKK, Zyra e punësimit | OSHC-të, Donatorët |
| 2.1.2 | **Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet ashkali dhe rom (i të papunëve dhe punëkërkuesve) dhe ofrimi i këshillave për punësim** | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet ashkali dhe rom (i të papunëve dhe punëkërkuesve) dhe harton një databazë. Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme me qëllim të rritjes së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve. | 2024-2026 | ZKKK, Zyra e punësimit | OSHC-të, Donatorët |
| 2.1.3 | **Ofrimi i kurseve shtesë për aftësim profesional dhe kurseve artizanale për punëkërkuesit nga komunitetet** | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e të gjithë punëkërkuesve nga komunitetet rom dhe ashkali. Në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkuesve nga komunitetet rom dhe ashkali, harton plane për përfshirjen në kurse për aftësim profesional.<br>Në rastet kur kurset që kërkohen (sidomos ato artizanale) ZKKK dhe Zyra e punësimit mund [illegible] | 2024-2026 | Komuna | OSHC-të, Donatorët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | të hapur biznese të reja | komuniteti i donatorëve është i interesuar për të përkrahur krijimin e bizneseve të reja. Komuna do të shfrytëzoj këto mundësi duke participuar me mjete vetanake në nisma të tilla. | | | |
| | | | | Nën-Totali 2.1 | |
| **Rezultati 2.2** | **Përmirësohet pjesëmarrja në skemat sociale e familjeve në nevojë nga komunitetet rom dhe ashkali** | | | | |
| **Kodi** | **Aktiviteti** | **Përshkrimi i Aktivitetit** | **Periudha e implementimit** | **Përgjegjësia** | **Institucioni/organizata mbështetëse** |
| 2.2.1 | **Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të familjeve në nevojë për përfshirje në skemat sociale** | Në Komunën e Shtimes ka pasur raste, kur familjet në nevojë për shkak të neglizhencës kanë humbur asistencën sociale, apo nuk janë fare përfitues të skemave sociale. Kjo ka ardhur si pasojë e mos-informimit të familjeve me kushtet, procedurat dhe kriteret për të qenë përfitues i skemave sociale.<br>Për të shmangur situata të tilla, ZKKK, DShMS dhe QPS në bashkëpunim me OSHC-të identifikojnë nevojat e të gjitha familjeve nga komunitetet ashkali dhe rom që kanë nevojë për tu përfshirë në skema sociale. Sipas nevojave të identifikuara, DSHMS dhe QPS do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për ti përfshirë në skemat sociale familjet në nevojë. Theks i veçantë do ti kushtohet familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kuafizuar. | 2024-2026 | ZKKK, DSHMS | QPS, OSHC-të, Donatorët |
| 2.2.2 | **Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali** | Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmoshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve. ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga familja, apo grupet tjera të interesit | 2024-2026 | ZKKK, DSHMS | OSHC-të, Donatorët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | ... komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale | ... (koordinator), DSHMS, QPS, Zyra e punësimit, DKA, OJQ-të, bizneset etj. Varësisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes. | | | OSHC-të, Donatorët |
| 2.2.4 | Organizim i takimeve periodike për koordinim në mes të sektorëve | ZKKK si koordinatore e Grupit koordinues do të organizojë takime periodike (2 herë në vit) për të siguruar që janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale.<br>Varësisht nga nevoja, ky Grup mund të takohet edhe më shpesh për të trajtuar çështjet dhe sfidat që paraqiten. | 2024-2026 | ZKKK | DSHMS, QPS, DKA, Zyra e Punësimit, OShC-të, Donatorët |
| | | | | Nën-Totali 2.2 | |

**Fusha:** SHËNDETËSIA

**Objektivi 3:** Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës te pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali

**Rezultati 3.1** Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali

| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.1.1 | Organizimi i vizitave periodike shëndetësore ne familjet e komuniteteve nga QKMF | Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime.<br>QKMF me përkrahjen e DSHMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë ... | 2024-2026 | QKMF / QMF | DSHMS, ZKKK |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | imunizuar dhe imunizimi i tyre | bëhet imunizimi i tyre. Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me Qendrat e Komuniteteve (aty ku ekzistojnë), OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore. | | QKMF / QMF | |
| 3.1.3 | Ndarja e buxhetit për trajtimin e rasteve shëndetësore nga komunitetet | Shërbimet që ofrohen nga QKMF dhe QMF shpeshherë nuk i përmbushin nevojat e pacienteve, veçmas kur paraqiten raste më të rënda të cilat kanë nevojë për një tretman më të veçantë. Praktikat e mëhershme nga Komuna e Shtimes, tregojnë se në disa raste Komuna ka ndihmuar financiarisht trajtimin e këtyre rasteve. Duke u bazuar në supozimin që pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali janë më të predispozuar ndaj këtyre rasteve, nevojitet një fond i paracaktuar për të ndihmuar këto raste. ZKKK do të ketë rol koordinues në identifikimin e këtyre rasteve, apo do të jetë adresë për të kërkuar ndihmën e tillë. Ndërsa, mjetet për trajtimin e këtyre rasteve do të ndahet direkt nga Komuna. | 2024-2026 | Komuna | ZKKK, DSHMS |
| | | | | Nën-Totali 3.1 | |

| Rezultati 3.2 | Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse |
| | Organizimi i ligjëratave rreth | DSHMS në bashkëpunim të ngushtë QKMF dhe QMF duhet të organizojnë ligjërata të strukturuara rreth edukimit | | DSHMS, | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.2.2 | **Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF** | me OSHC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom dhe ashkali, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF. | 2024-2026 | DSHMS, QKMF / QMF, ZKKK | OSHC-të, Donatorët |
| 3.2.3 | **Organizimi i vizitave periodike për mamografi – ne koordinim me ZKKK** | DSHMS në bashkëpunim me ZKKK dhe MSh/QKUK organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit Mobil që menaxhohet nga MSH. | 2024-2026 | ZKKK, DSHMS | QKUK, MSh |
| | | | | **Nën-Totali 3.2** | |
| [redacted] | | | | | |

| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse | I |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.1 | **Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim** | ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkali bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim..<br>Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të inëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, ri-atdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim. | 2024-2026 | ZKKK | DSHMS, OJQ | |
| 4.1.2 | **Zbatimi i kritereve për përfituesit e mundshëm / për ndërtim apo renovim të shtëpisë sipas Programit trevjeçar të banimit** | ZKKK në koordinim me donatorët dhe me përgjegjësit do të përkujdeset që Programi trevjeçar i banimit të zbatohet dhe të shfrytëzohen kriterei që burojnë nga ky program për përzgjedhjen e përfituesve të ndërtimit/renovimit të shtëpive për nevojtarët | 2024-2026 | Komuna | OSHC-të, Donatorët | |
| 4.1.3 | **Monitorim i vazhdueshëm i procesit të shpalljes së përfituesve të objekteve të banimit apo renovimit të shtëpive ekzistuese** | Komuna në bashkëpunim me ZKKK do të përkujdesen që procesi i ndarjes së banesave / përcaktimit të përfituesve potencial do të jetë proces transparent.<br>OSHC-të do të kenë rol monitorues gjatë gjithë procesit, ndërsa dokumentet e prodhuara nga ky proces duhet të jenë të qasshme për të gjithë të interesuarit.<br>Pas procesit të ndarjes së banesave / përcaktimit të përfituesve potencial për renovim, Komuna duhet të hartoj një raport përmbledhës i cili do të jetë në dispozicion për publikun. | 2024-2026 | Komuna, ZKKK | OSHC-të, Donatorët | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.1 | **Organizimi i takimeve avokuese për të adresuar problemin e banimit për komunitetet në veçanti të rikthyerit – Rëndesia e themelimit të Fondit Emergjent** | Përfaqësuesit e ZKKK zhvillojnë një plan të takimeve me Kabinetin e Kryetarit dhe me asambleistës për të adresuar problemin e banimit për komunitetet e në veçanti për rastet e rikthyer apo rastet që nuk e kanë të zgjidhur këtë problem. Takimet do të kenë karakter avokues, në mënyrë që të shtyhet përpara Themelimi i Fondit Emergjent për rastet e banimit. Ndretimi i shtepive. | 2024-2026 | ZKKK | Kryetari i Komunës, OSHC-të, Donatorët | |
| 4.2.2 | **Hartimi i dokumentacionit përcjellës për themelimin e Fondit** | ZKKK merr rol kryesor në hartimin e dokumentacionit për themelimin e Fondit Emergjent për rastet e banimit. ZKKK me përkrahjen e kabinetit të kryetarit caktojnë grupin punues për të hartuar dokumentacionin përcjellës për themelimin e këtij Fondi. Dokumenti kryesor që duhet të hartohet është: Akti i Themelimit - Statuti; ku do të përfshihen këto informata:<br>- Mënyra e shfrytëzimit te Fondit<br>- Rastet kur mund të shfrytëzohet Fondi<br>- Kriteret për përfituesit nga ky Fond<br>- Caktimi i mekanizmit në nivel komunal për menaxhimin e Fondit<br>- Shfrytëzimi i Fondit për bashkëfinancim i projekteve te donatorëve etj. | 2024-2026 | ZKKK | Kryetari i Komunës, OSHC-të, Donatorët | d |
| 4.2.3 | **Takime periodike me donatorët potencial që do të kontribuonin në Fondin Emergjent për Banim** | ZKKK në koordinim me Kryetarin e Komunës organizon konferencë të donatorëve një herë në vit me qëllim të informimit për ekzistimin e një Fondi të tillë dhe mundësisë së gjetjes së mënyrave të bashkëpunimit / bashkëfinancimit të projekteve të ndryshme që kanë për qëllim zgjidhjen e problemit të banimit për rastet në nevojë. | 2024-2026 | ZKKK | Kryetari i Komunës, OSHC-të, Donatorët | S K e 2 |
| | | | | **Nën-Totali 4.2** | | |

| Rezultati 5.1 | Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të diskriminimit ndaj pjesëtar[ve të komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse | Pi |
| 5.1.1 | Identifikimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i nevojave për parandalimin e diskriminimit | Identifikimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i nevojave për aftësimin e nëpunësve civil të Komunës për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit dhe diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali | 2024-2026 | ZKKK | DA, DSHMS, OJQ | S |

Objektivi 5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykimit, stereotipeve dhe bullizmit

**SHTOJCA 1**

Ky dokument është përgaditur me përkrahjen e Instuticioneve të Komunës së Shtimes dhe përfaqësuesëve nga organizata joqeveritare me eksperiencë në trajtimin e çështjeve lidhur me gjendjen e komuniteteve joshumicë. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi ekskluzive e hartuesve dhe në asnjë rrethanë, nuk duhet t'i atribuohet donatorit dhe organizatave implementuese.

**GRUPI PUNUES:**

1. Faruk Beqa-Nenkryetar,Kryesues i grupit punues.
2. Gentiana Mehmeti-Koordinatore e KKV-së
3. Ylika Fejzullahu – Drejtoreshë e Drejtorisë Komunale për Arsim;
4. Muharrem Asllani – Drejtor i Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
5. Grejtalb Emini – Drejtor i Drejtorisë Komunale për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi;
6. Elfete Shabani – Ud. Për Komunitete dhe Kthim
7. Reshat Gashi – Zyrtari Komunal për të drejtat e njeriut dhe Zyrtar për Barazi Gjinore;
8. Fatmire Ferati – Zyrtare në DKRS;
9. Kimete Uka – Zyrtare Kryesore për Financa;
10. Muhamet Mehmeti – Përfaqësues i OJQ-së Balkan Sunflowers Kosova në Prishtinë;
11. Ergjan Mehmeti– Përfaqësues i OJQ-së Art Stars Union në Shtime;
12. Bajram Ilazi – Përfaqësues i OJQ-së VORAE në Graçanicë;
13. Arjeta Maliqi – Përfaqësuese e OJQ-së Bashkimi Rinor për Bashkëveprim në Shtime.

v.v.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Adnan Ademi**

____________________

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

**Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office**

| | |
|---|---|
| Data/Datum/Date: | 18.3.2024 |
| Nr./Br./No: | 02/187 |
| Për/Za/To: | Kuvendi i Komunës-Shtime, Kryesuesi z. Adnan Ademi |
| Nga/Od/From: | Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu |
| Lënda/Predmet/Subject : | Propozim-Vendim për formimin e komisioneve për ndarjen e titujve "Sakrifica e Reçakut , 1999" dhe " Pena e Artë" |

Të nderuar anëtarë të Kuvendit e Komunës së Shtimes;

Në mbështetje të vendimit 01/83 të datës 26.02.2024 të Kuvendit të Komunës së Shtimes për miratimin e çelësit për zgjedhjen e Komisioneve për ndarjen e çmimeve "Sakrifica e Reçakut, 1999" dhe "Pena e Artë", si dhe në bazë të nenit 10 të Rregullores Komunale Npi - 01/173 të dates 27.05.2009 për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, si dhe të nxitur nga nevoja e ndarjes së dekoratave për personalitetet e ndryshme që kanë dhënë kontribut domethënës, ashtu që konform procedurave të kemi mundësinë për t'i nderuar nga Komuna e Shtimes, në mbështetje të procedurës së kërkuar sipas dispozitave të aktit nënligjor, ju ftoj të miratoni këtë Propozim-vendim për formimin e komisioneve për ndarjen e titujve "Sakrifica e Reçakut, 1999" dhe "Pena e Artë"

**Formimi i Komisionit për ndarjen e titullit "Sakrifica e Reçakut, 1999":**

1. ____________________ Anëtar nga Kuvendi,
2. ____________________ Anëtar nga Kuvendi,
3. ____________________ I emëruar nga Kryetari i Komunës,
4. ____________________ Nga Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së,
5. ____________________ Nga Shoqëria Civile.

**Formimi i Komisionit për ndarjen e titullit "Pena e Artë":**

1. ____________________ Anëtar nga Kuvendi,
2. ____________________ Anëtar nga Kuvendi,
3. ____________________ I emëruar nga Kryetari i Komunës,
4. ____________________ I emëruar nga Kryetari i Komunës,
5. ____________________ Nga Shoqëria Civile.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opstine/ Mayor's Office

| | |
|---|---|
| Data/Datum/Date: | 21.03.2024 |
| Nr./Br./No: | 02/ 207 |
| Për/Za/To: | Kuvendi Komunal - Shtime |
| Nga/Od/From: | Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi<br>Drejtor, Grejtalb Emini |
| Përmes/Preko/Through: | Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Aliu |
| Lënda/Predmet/Subject : | Propozim- Vendim |

**Propozim-Vendim për për marrjen e drejtës shfrytëzimit të paluajtshmërive NPKSH Higjiena dhe Kryqi Kuq i Kosovës – Shtime.**

Në bazë te neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; neni 53 Statutit të Komunës së Shtimes; neni 2 i Ligjit të Eksproprijimit (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit ligj është dhënë në shfytëzim prona komunale) dhe në mbështetje të nenit 4 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligji nr. 03/L-205 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm, të kërkesës së Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përmes Kryetarit të Komunës së Shtimes propozojm:
Marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të NPKSH "Higjena"- Parcela kadastrale me nr P-72809093-02148-4, në Zonën Kadastrale Shtime dhe Kryqi i Kuq i Kosovës – dega në Shtime Parcela kadastrale me nr P-72809093-02148-10, në Zonën Kadastrale Shtime.

**Arsyetim**: Parcela kadastrale me nr P-72809093-02148-4 me sipërfaqe prej 2000 m² sipas vendimit 01/347/2, datë 27.09.2002- ju është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, NPKSH "Higjena"
Parcela kadastrale me nr P-72809093-02148-10 me sipërfaqe prej 1000 m² sipas vendimit 01/6/3867, datë 25.11.2005- ju është dhënë në shfrytëzim Kryqit të Kuq të Kosovës – dega në Shtime, në Zonën Kadastrale Shtime.
Komuna e Shtimës si subjekt publik nuk posedon paluajtshmëri e cila evidentohet në emër të Komunës që i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të Administratës së Komunës së Shtimës

Bashkangjitur me kërkesë janë:
- Vendimi 01/347/2, datë 27.09.2002- për dhënje në shfrytëzim të përkohshëm, NPKSH "Higjena".
- Vendimit 01/6/3867, datë 25.11.2005- për dhënje në shfrytëzim Kryqit të Kuq të Kosovës–dega në Shtime
- Certifikatat mbi pronat dhe Kopjet e Planit të parcelave,

- Marrveshje per bashkfinancim ndërmjet Ministrisë së Punëve të Mbrendshme dhe Komunës së Shtimes për bashkfinacim dhe realizim të projektit Ndërrtimi i Objektit të Komunës së Shtimes , të cilat janë objekt i Propozim - Vendimit.

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +383290389016, email: info@shtime-komuna.org
http://kk.rks-gov.net/shtime

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shtime

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72809093-02148-4 | Parcelë / Parcela / Parcel | 2000 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:415

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 23.01.2024

Koha/ Vreme/ Time: 01:23:53

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shtime

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72809093-02148-10 | Parcelë / Parcela / Parcel | 1000 |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:326

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 23.01.2024
Koha/ Vreme/ Time: 01:24:51

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-02148-10

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 121/24 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 23.01.2024 - 13:19 |
| Komuna / Opština / Municipality: | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Shtime / Štimlje / Shtime |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME |

## A: TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72809093-02148-10 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 1000 | | | 11.12.2015 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| KRYQ | | | | 11.12.2015 |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Kadrije.Zeqa | P-72809093-02148-10 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pyjor/šumsko/Forestry | Tokat Pyjore/šumsko zemljište/Forest | Mal I Klasës 2/Suma 2 Klase/2nd Class Forest | 1000 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | P.SH.E K.K.SHTIME SHFRYTËZUES KRYQI KUQ I KOSOVËS PASURI | | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME / | | | 1/1 | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-02148-4

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 121/24 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 23.01.2024 - 13:18 |
| Komuna / Opština / Municipality: | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Shtime / Štimlje / Shtime |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhurnuar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72809093-02148-4 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 2000 | 17-2003 | | 11.12.2015 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice Street name | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhurnuar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| KRYQ | | | | 11.12.2015 |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Kadrije Zeqa | P-72809093-02148-4 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pyjor/šumsko/Forestry | Tokat Pyjore/šumsko zemljište/Forest | Mal I Klasës 2/Suma 2 Klase/2nd Class Forest | 2000 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | PASURI SHOQËRORE-SHFRYTËZUES NPKSH HIGJIENA | KCID2894700 | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME / | | | 1/1 | 17-2003 | |

## G. NGARKESAT TJERA - OSTALI TERETI - OTHER ENCUMBRANCES

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Shuma e borxhit<br>Iznos duga<br>Amount Debt | Shuma e borxhit me shkronja<br>Iznos duga slovima<br>Amount Debt in Writing | Date e skadimit të afatit<br>Datum isteka roka vraćanja<br>Due Date | Afati dhe kushtet<br>Rokovi i uslovi<br>Terms and conditions | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ngarkesat tjera / Komponenta ostalih sluzbenosti / Other encumbrances | | | | | Parcela nr.02148-4 | |

C420 4
27.10.2022

02/559
6
28.10.2022
SHTIME-STIMLJE
27.10.2022
02/659

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrasnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Komuna e Shtimes
Opština Stimlje
Municipality of Shtime

# MARRËVSHJE PËR BASHKËFINANCIM

# NDËRMJET

# MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

# DHE

# KOMUNËS SË SHTIMES

# PËR

# BASHKËFINANCIM DHE REALIZIM TË PROJEKTIT

# "NDËRTIMI I OBJEKTIT TË KOMUNËS SË SHTIMES"

Tetor 2022, Prishtinë

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë "MPB"), rruga "Luan Haradinaj" pn. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, në njërën anë dhe

Komuna e Shtimes e Republikës së Kosovës ( në tekstin e mëtejmë "Komuna"), rruga "Tahir Sinani", nr. 50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës, në anën tjetër.

Në tekstin vijues të referuara bashkërisht si "Palët" janë pajtuar si më poshtë:

**Neni 1**
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të definojë të drejtat dhe detyrimet e palëve, afatet dhe kushtet tjera lidhur me financimin dhe realizimin e projektit "**ndërtimi i objektit të komunës së Shtimes**".

**Neni 2**
**Mënyra e bashkëfinancimit**

1. Vlera totale e projektit "**ndërtimi i objektit të komunës së Shtimes**" parashihet të jetë rreth 2,500,000 euro (dy milion e pesëqind mijë euro).

2. Kostoja totale (vlera e parashikuar dhe po ashtu edhe çdo vlerë tjetër që tejkalon vlerën e parashikuar) e këtij projekti do të bashkë financohet 20% nga Komuna dhe 80% nga MPB.

3. Bashkëfinancimi, respektivisht ekzekutimi i pagesave në mënyrë të detajuar do të rregullohet përmes kushteve të kontratës së realizimit të projektit në harmoni me legjislacionet në fuqi.

**Neni 3**
**Detyrimet e MPB-së**

1. MPB-ja, i zoton mjetet për projektin nga neni 2, pika 1 dhe 2 sipas kësaj Marrëveshjeje, për çdo vit fiskal 2023, 2024 dhe 2025 dhe një kopje e dërgon tek të gjitha palët.

2. Është bartëse kryesore e projektit "**Ndërtimi i objektit të komunës së Shtimes**".

3. MPB-ja do të zhvillojë procedurat e prokurimit dhe realizimit të projektit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me këtë marrëveshje.

4. MPB-ja do të emërojë projekt menaxherin dhe do të kërkojë nga Komuna një person përgjegjës për t'i asistuar projekt menaxherit.

5. MPB-ja do të emërojë organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe komisionin për pranimin teknik të punimeve duke u siguruar që së paku një anëtar i Komunës të jetë i përfshirë në organin mbikëqyrës për realizimin e projektit dhe po ashtu së paku një anëtar i Komunës në komisionin e pranimit teknik.



XH.S F.B

6. Pagesat nga MPB për vlerën e bashkëfinancimit do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve sipas kushteve kontraktuale.

**Neni 4**
**Detyrimet e Komunës**

1. Komuna do të zotojë mjetet financiare për projektin nga neni 2, pika 1 dhe 2 sipas kësaj marrëveshjeje për çdo vit fiskal 2023, 2024 dhe 2025 dhe një kopje e dërgon në MPB.

2. Komuna do të caktojë një zyrtar përgjegjës për asistim menaxherit të kontratës.

3. Komuna do të caktojë së paku nga një zyrtar përgjegjës si anëtarë në organin mbikëqyrës të realizimit të punimeve dhe në komisionin e pranimit teknik.

4. Komuna do të kryej pagesat për pjesën e bashkëfinancimit konform nenit 3 pika 6 e kësaj marrëveshje.

5. Komuna është përgjegjëse për dizajnimin dhe financimin e projektit të detajuar të ndërtimit të objektit.

6. Komuna është përgjegjëse që të sigurojë dhe financojë të gjitha kushtet ndërtimore dhe lejet relevante (lejen urbanistike, lejen e ndërtimit për projektin, kyçjet në infrastrukturë) jo më larg se 15 ditë pas kompletimit të dokumentacionit.

7. Komuna do të sigurojë që personat fizik dhe/apo juridik të mos pengojnë në realizimin e këtij projekti.

**Neni 5**
**Afati i realizimit të projektit**

MPB dhe Komuna duhet të ndërmarrin të gjitha masat që projekti të përfundojë brenda vitit fiskal 2025.

**Neni 6**
**Pronësia e projektit**

1. Pas realizimit të projektit sipas kësaj marrëveshjeje, pronësia e objektit do të regjistrohet në pronësi të Komunës.

2. Komuna është e detyruar të regjistrojë objektin nën pronësi të saj.

3. Objekti kalon në pronësi të Komunës në rastin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, pagesën e fundit dhe pranimin teknik.



F.B

XH.S

**Neni 7**
**Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes**

1. Marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas pëlqimit paraprak të të dyja palëve nënshkruese.

2. MPB mban të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se konstaton se pala tjetër nënshkruese nuk i përmbush obligimet e ndërmarra me këtë Marrëveshje.

**Neni 8**
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët zotohen se do të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje dhe obligimet që parashihen në të. Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore dhe të përshtatshme të gjitha mosmarrëveshjet eventuale që dalin nga kjo marrëveshje.

2. Nëse tentativat për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve nuk kanë sukses, kontesti do ti drejtohet Gjykatës kompetente, në bazë të ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

**Neni 9**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Palët.

2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në gjuhët zyrtare të RKS në 4 (katër) kopje autentike, një për secilën palë nënshkruese, një për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe një për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Xhelal SVEÇLA

Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Datë: 27.10.2022

Qemajl ALIU

Kryetar i Komunës së Shtimes

Datë: 27.10.2022

**KUVENDI KOMUNAL – SHTIME**
**Nr 01/6/3867**
**Datë 25/11/2005**

Në bazë të nenit 70 të Ligjit mbi Eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr 21/78) si dhe në bazë të pëlqimit nga Drejtoria për Planifikim, Rindërtim Zhvillim dhe Urbanizëm, Kuvendi Komunal, në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2005, mori këtë :

# VENDIM

I. I merret e drejta e shfrytëzimit Ekonomisë Pyjore (Agjencionit Pyjor të Kosovës) në pjesën e ngastrës kadastrale me nr 02148-1, në vendin e quajtur »Kryqe« me kulturë mal, i klasës së II-të, në sipërfaqe prej 00.10.00 ha (1000 m²) të shënuar në Çertifikatën mbi pronën e patundshme, nr 00940 Zona Kadastrale - Shtime

II. I jepet në shfrytëzim Shoqatës »Kryqi i Kuq« i Kosovës pjesa e ngastrës të shënuar në pikën I të këtij vendimi për ndërtimin e objektit të administrates për ushtrimin e veprimtarisë së kësaj shoqate.

III. Obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi që në bazë të këtij vendimi të bëjë ndërrimin në librat kadastralë.

# ARSYETIM

Kuvendi Komunal në Shtime në bazë të kërkesës nr 01/07/3841 të ushtruar nga përfaqsuesi i Shoqatë »Kryqi i Kuq« i Kosovës dega në Shtime, Z. Nazmi Shahini në lidhje me ndarjen e parcelës për ngritjen e objektit për nevoja të administrates së Shoqatës e në bazë të pëlqimit të Drejtorisë për planifikim, rindërtim zhvillim dhe urbanizëm i merr të drejtën e shfrytëzimit Ekonomisë Pyjore) në pjesën e ngastrës kadastrale me nr 02148-1 në vendin e quajtur »Kryqe« me kulture mal i klasës II-të në sipërfaqe prej 00.10.00 ha (1000 m²) të shënuar në Çertifikatën mbi pronën e patundshme nr 00940 Zona Kadastrale – Shtime

Vendimi u mor në bazë të aprovimit paraprak të kërkesës nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

Kryetari i Kuvendit
Fatmir Rashiti

KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
Nr. 01/347/2
Data: 27.09.2002

Në bazë të Propozimvendimit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të ngastrës kadastrale nr 2148, në bazë të nenit 70 të Ligjit të aplikueshëm mbi Eksproprijimin (Gazata zyrtare e Kosovës nr 21/78) si dhe në bazë të Pëlqimit të Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Zhvillim dhe Urbanizëm, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2002 mori këtë:

# VENDIM

Me këtë Vendim Kuvendi Komunal i merr të drejtën e shfrytëzimit Ekonomisë pyjore në Ferizaj (Autoritetit Pyjorë të Kosovës) të ngastrës kadastrale nr 2148 në vendin e quajtur »Krst«, me kulturë mal e klasit të dytë në sip. prej 00.20.00 ha të shënuar në fletën poseduese nr 940 Zona Kadastrale Shtime.

Ngastra Kadastrale i ipet në shfrytëzim të përkohshëm NPKSH "Higjiena" nga Shtimja me qëllim të ngritjes së objektit të administratës dhe autoparkut, për nevoja të veta.

OBLIGOHET Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi të bëjë ndërrimin në librat Kadastrale.

# ARSYETIM

Kuvendi Komunal në bazë të Propozimvendimit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, nr. 06/563/146 dhe Pëlqimit të Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Zhvillim dhe Urbanizëm, merr të drejtën e shfrytëzimit Ekonomisë Pyjore (Autoritetit Pyjorë të Kosovës) të ngastrës kadastrale nr. 2148 në vendin e quajtur »Krst«, me kulturë mal e klasit të dytë në sip. prej 00.20.00 ha të shënuar në fletën poseduese nr 940 Zona Kadastrale Shtime.

Shtime, më 27.09.2002

Kryetari

Zalit Agalawatta
Municipal Administrator

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opstine/ Mayor's Office

| | |
|---|---|
| Data/Datum/Date: | 20.03.2024 |
| Nr./Br./No: | 02/204 |
| Për/Za/To: | Kuvendi Komunal - Shtime |
| Nga/Od/From: | Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi<br>Drejtor, Grejtalb Emini |
| Përmes/Preko/Through: | Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Aliu |
| Lënda/Predmet/Subject : | Propozim- Vendim |

**Propozim-Vendim për Ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Npi – 01/190 datë 30.06.2022 Për ndarjen e 700 m² Truall për Ndërtimin e Kopshtit për Fëmijë në fshatin Petrovë.**

Në bazë te neni 58, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53; Në bazë të arsyetimit nga Drejtoria e Arsimit Nr.05/158 datë 19.03.2024; të kërkesës së Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përmes Kryetarit të Komunës së Shtimes propozojm Kuvendit të Komunës së Shtimes ndryshimin e pikës I të Vendimit të Kuvendit Npi – 01/190 të datës 30.06.2022, për ndarjen e 700 m² (7ari) Truall për ndërtimin e kopshtit për fëmijë në fshatin Petrovë, në të cilën në vend të 700 m² (7 ari) të ndryshohet në 1500 m² (15 ari) në pjesën e ngastrës kadastrale P-72809066-01012-1, Zona Kadastrale Petrovë, evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes. Ndryshimi i Vendimit konsiston në ekzistimin e kritereve të vendusuara nga MASHT-i për ndërtimin e objektit për kopshtë të fëmijëve ku sipas specifikave kërkon hapsirë më të madhe, pasi që objekti duhet të jetë përdhes e jo në dy etazhe, andaj është e nevojshme që të sigurohet hapsirë më e madhe për ndërtimin e këtij obejkti.

Bashkangjitur me kërkesë janë Certifikata mbi pronën dhe Kopja e Planit të parcelës, Arsyetimin e DKA-së, kopjen e planit të objektit si dhe email-in zyrtarë, të cilat janë objekt i kërkesës për ndryshimin e Vendimit.

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +383290389016, email: info@shtime-komuna.org
http://kk.rks-gov.net/shtime

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

| | |
|---|---|
| DATË | 19.03.2024 |
| NR. | 05/158 |

| | |
|---|---|
| PËR | **Grejtalb Emini**, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi |
| NGA | **Yllka Fejzullahu**, drejtoreshë e DKA-së |
| LËNDA | ARSYETIM LIDHUR ME KËRKESËN PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NPI-01/190 DATË 30.06.2022 |

Përmes kësaj shkrese po ju njoftojmë se parcela numër P-72809066-01012-1 zona kadastrale- Petrovë e destinuar për ndërtimin e objektit të ri të çerdhes në fshatin Petrovë sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Npi-01/190 i datës 30.06.2022 është hapësirë e pamjaftueshme për destinimin e kërkuar sepse sipas MASHTI-it projekti që synohet të realizohet kërkon hapësirë më të madhe referuar specifikave i cili kërkon që të jetë objekt përdhese e jo në dy etazhe andaj edhe rrjedhimisht kërkon hapësirë më të madhe.

Hapësira e përgjithshme e parcelës duhet të jetë 15 ari. dhe sipas vendimit aktual në shfrytëzim janë 7 ari të cilat janë të pamjaftueshme andaj t'i shtohen edhe 8 ari tjerë.

Ju lusim si dëshmi gjeni: e-mail adresën nga MASHTI dhe
Projekti për ndërtimin e çerdhes në Petrovë.





REVISIONI:

| Nr. | Dt. | Modifikimi | Nr. |
|---|---|---|---|
| | | | |

ZYRA PROJEKTUESE:

enggroup

Tel: +383(0)44270745
Email: info@enggroup-ks.com
Adresa: Rr.Nebih Gashi
B26,O22,Kati1
10000 Prishtinë/Kosovë

INVESTITOR:
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**
Republika e Kosovës

PROJEKTI:
Qerdhe-Kopësht për fëmijë- grupmosha 1-4vjet
Republika e Kosovës

NUMRI I PROJEKTIT:
P-202105

FAZA E PROJEKTIT:
Arkitektura - Projekti Kryesor

EMERTIMI I VIZATIMIT:
Dukjet 3D

PROJEKTANTI KRYESOR:
MSc.Tirana Selimi

PROJEKTUES:

PROJEKT MENAXHER:
/

KONTROLLOI:
/

DATA:
05.11.2022

PËRPJESA:

FORMATI:
A3 ext - 420 x 297 mm

NUMRI I FLETËS:
A.10


FASADA PERENDIMORE
HYRJA KRYESORE
FASADA PERENDIMORE
FASADA JUGORE
FASADA VERIORE
DALJET NË TERASË
DALJET NË TERASË
DALJET NË TERASË
DALJET NË TERASË
HYRJA EKONOMIKE
FASADA JUGORE
FASADA LINDORE
FASADA LINDORE
FASADA VERIORE


FASADA PERENDIMORE
FASADA PERENDIMORE
FASADA JUGORE
FASADA VERIORE
FASADA JUGORE
FASADA VERIORE
FASADA LINDORE
FASADA LINDORE

From: Isuf Gashi <Isuf.Gashi@rks-gov.net>
Date: February 28, 2024 at 09:23:51 GMT+1
To: Yllka Fejzullahu <yllka.fejzullahu@rks-gov.net>, dani.xh@hotmail.com
Cc: Fadile Dyla <Fadile.Dyla@rks-gov.net>, Besim Muharremi <Besim.Muharremi@rks-gov.net>, Naim Demiri <Naim.Demiri@rks-gov.net>, Jetesa Qerimi <Jetesa.Qerimi@rks-gov.net>
Subject: njoftim

E nderuar drejtoreshë znj.Yllka, pas takimit që patëm dje me zyrtaret tuaj z.Idriz dhe z.Ramadan dhe vizites ne lokacionin e përcaktuar nga komuna e Shtimes per ndërtimin e çerdhes në Petrove konstatuam se lokacioni i ndarë vetem 7 ari (700 m²) edhe pse në parcelen e caktuar kishte hapësire me te madhe, është i pa mjaftueshëm per ndertimin e çerdhes konkretisht te parapërgaditur –modulare sepse vetëm baza e objektit është 700 m² dhe forma ndryshe me lokacionin derisa parametrat e shfrytëzimit te tokës i përcakton drektoria e urbanizmit ne komunë në baze të planit rregullativ ose zhvillimor urban të aprovuar nga samblеja komunale. Si rezultat duhet siperfaqe më me madhe për aplikimin e projektit. Poashtu po ju dërgoj edhe një version të një project-dizajni monolit-betonarme, i cili duhet të pershtatet për lokacionin por që ka dimensione të bazës me të vogla por qe prap kërkon lokacion më të madhë dhe gjithesesi do të duhej të shqyrtonej nese ka nevojë te ndërtohet edhe kati ose mjafton vetëm përdhesa.

Isuf Gashi
Udhëheqes i divizionit për Planifikim dhe Standarde të Infrastruktures Shkollore
Departamenti i Arsimit Parauniversitar
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Republika e Kosovës

e-mail: isuf.gashi@rks-gov.net
tel: 038 211 996
mob: +383 44 103 235

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Petrovë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-72809066-01012-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 19218 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:2586

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 19.03.2024

Koha/ Vreme/ Time: 01:56:11

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809066-01012-1

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 326/24 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 19.03.2024 - 13:54 |
| Komuna / Opština / Municipality: | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Petrovë / Petrovo / Petrovë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME |

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area ($m^2$) | Përshkrimi<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72809066-01012-1 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 19218 | | 15.11.2019 | |

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| RASHITOVIT | | | 15.11.2019 | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Kadrije Zeqa | P-72809066-01012-1

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | 3431 |
| 1 | Shërbimet Publike/Javne Usluge/PublicServices | Varrezë/Groblje/cemetery | | 11316 |
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 4471 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | Komuna e Shtimes | 600258976 | SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME / | | TAHIR SINANI | 1/1 | | 19.11.2019 |